

REPUBLIKA E SHQIPERISË
SHOQËRIA “A-XH-19” SHPK

NIPT: L97729201N

PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

**PROJEKTI “SHFRYTËZIM I MINERALIT TË KROMIT ME
MINIERË DHE KARRIERË”**

OBJEKTI “QAFË KAM”, BASHKIA TROPOJË, QARKU KUKËS

NENTOR 2023

Hyrje.

Një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, të shoqëruar dhe me imazhe të marra jo më vonë se 6 muaj nga data e aplikimit;

Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;

Identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër;

Përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve;

Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

Ndikimet e mundshme në mjedisin ndër-kufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Hyrje.

Të dhëna mbi subjektin që kërkon të paiset me leje mjedisore:

Emri i subjektit sipas rregjistrimit në QKR: **“A-XH-2019”sh.p.k**
Zona minerare me numur identifikues **Leja minerare e shfrytezimit Nr 1900, datë 07.12.2020**
Lloji i mineralit/mineraleve per te cilin kerkohet dhenia e lejes: **Krom**
Tipi i lejes minerare: **Me nentoke dhe siperfaqe**
Emri dhe mbiemri i administratorit te subjektit aplikues per leje minerare sipas rregjistrimit ne QKR : **Atmir Vata.**
Adresa e selise se subjektit sipas rregjistrimit ne QKR: **Pallati 9-katësh, Shk nr.1, Ap nr.2, Lagja nr.5, Rruga “Eksod 99”, Kukës.**
Nr.telefonit mobile 0682041483
Emërtimi i njësisë vendore/njërive vendore ku përfshihet zona e kërkuar: **Njësia Administrative Bytyç”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës**
Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik: **Inxh. Gjeolog Faslli Tota**
Data e perfundimit te licenses profesionale se drejtuesit teknik: **Nr. 626, datë 15.01.2018, Pa afat.**

Kjo shoqëri ka si objek të veprimtarisë së saj,

- Studim dhe projektimit të hapjes, përgatitjes e shfrytëzimit të vendburimeve të mineraleve të dobishme me punime nëntokësore dhe sipërfaqësore.
- Shfrytëzimit të mineraleve të kromit, pasurimi i mineralit të kromit, shkrirjes së mineralit të kromit duke pasur si produkt përfundimtar koncentratin e kromit dhe të ferrokromit.
- Eksportin, importin dhe tregtimi i mineralit të Kromit, lëndëve të para dhe ndihmëse për prodhimin e ferrokromit, brenda dhe jashtë vendit.
- Magazinimi në depo i lëndëve plasëse dhe shpërthyes si dhe ruajtja e tyre për përdorim civil.
- Përdorimi i lëndëve plasëse dhe shpërthyes në kryerjen e punimeve për hapjen dhe shfrytëzimin e mineraleve në karriera e nëntokë për përdorim civil.
- Ndërtim hidrocentralesh dhe prodhim të energjisë elektrike.

Ne vitin 2020 shoqëria “A-XH-2019”sh.p.k shpk është pajisur me lejen minerare te shfrytezimit Nr-1900, datë 07/12/2020 e mineralit të kromit në objektin kromit “Qafë Kam”, Tropojë. Per shfrytezimin e ketij objekti shqeria ka investuar nje vlere prej 9 980 000 lek. Fale investimit te kesaj shoqeria është bere e mundur identifikimi i rezervave te reja gjeologjike. Brënda zonës të kërkim-shfrytezimit janë kryer punime gjeologjike nga ish ndërmjarrja gjeologjike Tropojë. Nga punimet e mëparshme të kryera nuk është arrit një shkallë e mirë e njohjes së ndërtimit gjeologo-strukturor dhe natyra e mineralizimit kromit në zonën e liçencuar pasi koha kur janë kryer këto punime ka qënë e shkurter dhe vëmendja në këtë zonë e pakët.

Në kuadër të kësaj leje minerare brënda territorin të lejes minerare së kërkim-shfrytezimit, është hartuar projekt kërkim-shfrytezimi ky janë thëlluar studimet gjeologjike (rilevimi gjeologo-strukture, hidrogjeologjik, kimik-industrial petrografik-mineralogjik etj) të zonës në tërësi dhe kryerjen e punimeve të kërkim-shfrytezimit për gjetjen dhe saktësimin e rezervave.

Pas një periudhe 3 vjeçare subjekti u pasi me leje minerare kërkim zbulimi Nr 1900, datë 7,12,2020, dhe bazuar në ligjin Nr 10304 datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, subjekti kërkon të paiset me leje minerare shfrytëzimi për këtë zonë minerare.

Filimisht duhet të paiset me leje mjedisore të tipit B, pastaj të vazhdojë procedurën për paisje me leje minerare shfrytëzimi.

Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi.

Zona ku ndodhet objekti minerar karakterizohet nga bimësi, të përbëhet kryesisht nga shkurre, dru bushi, më pak lisi. Në largësi të objektit në vendin e quajtur Maja e Fushave takohet pyllë ahu dhe kullotat alpine. Përsa i përket shkurreve ato kanë përhapje të kufizuar, ato takohen në pjesën JP, lindore dhe premdimore të zonës. Bushi është i pranishem në të gjithë zonen dhe në atë të punimeve.

Mbi lartësinë 850 m në veri dhe veriperendim të objektit, takohen pyje me dru ahu. Vete sipërfaqja ku do të kërkohet leja e kërkim - shfrytëzimit është pothuajse e zhveshurose me shkurre të rralla, si dhe nuk ka tokë bujqësore mbi atë. Theksojme gjithashtu së në këtë sipërfaqe nuk ka monumente kulture, vepra arti, argjinatura dhe vepra hidroenergjitike.

Përsa i takon sipërfaqes së zonës minerare, në këtë zonë nuk ka bimësi si rezultat i punimeve të kërkim shfrytëzimit.



Pamje të pjesëshme të sipërfaqes së objektit minerar



Pamje nga zona ku ndodhet objekti minerar



Pamje të zonës ku ndodhet objekti minerar, dhe pamje të pjeëshme të tij.

Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij.

Në pjesën perendimore zonës minerare Nr.659/1 ndodhet Përroi i Kamit i cili kalon në lindje të Lagjes Kam-Fshat dhe derdhet në jugëperndim në liqenin e Fierzes në zonen e fshatit Leniq. Në peridhen e pikut të reshjeve ky përroi ka prurje të larta, në periudhen e beharit pothuaj se shterron fare. Në lindje të zonës ndodhet Përroi I Kepenekut i cili kalon në Jug lindje në afërsi të fshatit Kepenek duke u derdhur në Lumin Skatinë edhe ky përroi ka pothuaj të njejtat karakteristika si ai i Kamit.

Zona përshkohet edhe nga disa proska, të cilat kanë ujë vetëm gjatë periudhës së reshjeve. Në brendësi të zonës ku do kryeh punimet e shfrytëzimit, nuk ka burime ujrash. Lidhur me veprimtarinë e ujrave nëntoksorë, kushtet hidrogeologjike të zonës minerare 659/1 ku do të kryhen punime kërkim-shfrytëzimi, janë shumë të përshtatëshme dhe nuk përbëjnë ndonjë problem për shfrytëzimin e këtij objekti në të ardhmen.

Si përfundim zona minerare 659/1, ka kushte të thjeshta hidrogeologjike, ujrata nëntokësore lidhen me çarjet e shkëmbinjve dunite-harzburgitik që ndërtojnë zonën ku ato lokalizohen dhe drenojnë mjaft mirë nëpërmjet rrjetit të dendur dhe të thellë të përrenjve që i përshkojnë ato.

Në sipërfaqe të kësaj zone nuk ka burime të ujrave sipërfaqësor dhe nëntoksorë.

Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër.

Aktivitetet minerare që zhvillohet me leje minerare shfrytëzimi, shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis. Prandaj konform kërkesave të ligjit minerare e akteve që rrjedhin prej tij, nga shoqëria jonë për punimet që do të zbatohet sipas këtij programi pune ka planifikuar shpenzime financiare për rehabilitimin e tij. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer, sidomos mbi burimet natyrore të parinovueshme. Industria minerare është shumë e rëndësishme për ekonominë e një vendi, por nga ana tjetër ajo shoqërohet edhe me ndikime mjedisore negative, të cilat në disa raste mund të jenë të pashmangshme.

Për të vlerësuar ndikimet e mundshme si pasoje e veprimtarisë, nisemi nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjeneruar, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Bazuar në projektin e dezignuar nga studio e licënsuar për projektimin e karrierave dhe minierave nëntoksore, ku janë projektuar punime sipërfaqësore dhe nëntokësore për zonën minerare të shfrytëzimit nr.Nr.659/1, punime minerare (galeri, pusëza) dhe ndoshta mund të kryhen edhe shpime pritët të kemi ndikim negative ne mjedis si :

- Dëmtimi i sipërfaqes se tokës gjatë hapjes dhe kryerjes së punimeve te shfrytëzimit.
- Depozitim te materialit te germuar ne siperfaqen e toke nga karriera dhe galeritë.
- Gjate procesit te punes mund te kete shkarim te pluhurit emetimin e gazrave nga paisjet dhe mjetet motorike.
- Mund te kete ndikim ne ujrata siperfaqesore nga derdhja e pakujdeseshme e vajrave, lubrifikanteve, naftes etj.

Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve.

Ujrat e ndotur

Zona ku propozohet projekti përshkohet nga disa proska, të cilat kanë ujë vetem gjatë periudhes së reshjeve. Në brendësi të zonës ku do kryeh punimet e shfrytëzimit, nuk ka burime ujrash. Lidhur me veprimtarinë e ujrave nëntoksorë, kushtet hidrogeologjike të zonës minerare Nr.659/1 ku jane projektuar të kryhen punime kërkim-shfrytezimi, janë shumë të përshtatëshme dhe nuk përbëjnë ndonjë problem.

- Gjithsesi per shkak te avarive te mundeshme do te merren masa ku do të piketohen dhe hapen kanalet e drenazhimit në sipërfaqet ku është germuar. Përgjatë segmenteve rrugore në varësi të terrenit dhe kushteve të tokës do të hapen kanale anësore që do të ndalim forcën gërryese të ujërave të reshjeve. Në pjese të veçanta do të shihet mundësia e mbjelljeve të fidanëve pyjore të përshtatshëm për zonën fito-klimatike.
- Makineritë që do të përdoren do të kontrollohen për gjendjen e tyre teknike dhe nëse konstatohen pjese të amortizuara që mund të rrjedhin lubrifikante do të zëvendësohen me të reja. Ne rast të ndonjë aksidenti dhe rrjedhjeve aksidentale të lëndëve ndotëse në mjedis do të merren masa për

pastrimin e menjëhershëm të tokës së ndotur e cila do të depozitohet në një kazan të posaçëm metalik ose prej betoni për t'u zhvendosur me pas.

Gazet

Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazesh të shkarkuar në atmosfere, Gazet prej mjeteve të punës janë në intervale kohore të shkurtra, brenda normave të lejuara pa ndonjë ndikim negativ në mjedisin përreth. Këto lloj mjetesh emetojnë sasira gazesh të cilat janë rezultat i punës së motorrave me djegie të brendëshme, brenda normave të lejuara. Mjete para se të vihen në punë janë objekt i kontrolleve teknike vecanërisht për emetimet e gazta nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor

Pluhuri

Operacionet e punës mund të gjenerojnë një sasi të lehta pluhuri çdo ditë, si rezultat i proceseve të germimeve dhe automjeteve që udhëtojnë rreth zonës. Automjetet që do të levizin në zonë janë vetëm ato që transportojnë puntore. Punonjësit që do të jenë prezent në objekt gjatë veprimtarisë do të jenë të mbrojtur nga mjetet personale mbrojtëse kundër pluhurit dhe zhurmave të cilat do të jenë të kufizuara vetëm brenda zonës së kërkimit shfrytëzimit. Si rrjedhojë e projektit dhe ndikimeve pasuese mjedisore në të, nuk do të ketë dhe nuk priten ndikime në shëndetin e popullsisë së zonës dhe punonjësve të saj.

Zhurma

Burimet e zhurmave janë në sipërfaqe. Çdo burim përhap vlerë zhurmë. Fusha akustike që rezultojnë varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimit të të gjitha pengesave ekzistuese, ndërmjet burimit dhe receptorit. Energjia zvogëlohet për gjatë rrugës si rezultat i absorbimit të sipërfaqeve, divergjencës gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Paisjet e makinerit që do të perdoren në këto aktivitete do të plotësojnë direktivën 2000/1/14/CE të Parlamentit Evropian dhe të KE 8 maj 2000, do të jenë të standartit të aplikueshëm në BE për zhurmat.

Nga ana e shoqërisë do të merren masa që makineritë do të mirëmbahen teknikisht që zhurma e tyre të jetë vetëm ajo teknologjike dhe jo e avarive. Ato duhet të perdoren me efikasitet dhe të minimizohet koha gjatë së cilës mbahen ndezur motorët. Skapamentot duhet të kenë në gjendje funksionale filtrat e tyre teknologjike të kapjes së grimcave (skapamentot e makinerive kanë një jastëk të posaçëm për këtë gjë). Do të perdoret naftë me përmbajtje të ulët squfuri. Transporti i materialeve të bëhet me mjete të pastra nga balta dhe të mbuluara nëse rrugët kalojnë pranë ose nëpër qendrat e banuara. Të mënjanohet rënia e borive të automjeteve nga shoferët për të mos krijuar zhurmë dhe stres tek banorët. Qarkullimi i kamionëve në qendrat e banuara të bëhet me shpejtësi të ulët gjë që shmang jo vetëm aksidentet por edhe krijimin e pluhurave.

Prodhimi i mbetjeve

Punimet e shfrytëzimit në këtë objekt nuk gjenerojnë mbetje të rrezikshme. Mbetjet strile që gjenerohen nga pastrimi i kanaleve të shkallëve, dhe ato të dalta nga pastrimi i galerive janë pjesë vegjetale e kores së tokës në një trashësi mesatare 0.3 m dhe janë të padëmshme në ambientin përreth.

- Sasia e materialit dhe sterilit që do të dalin nga gjermimet do të sistemohet përgjatë rrugës, në anët e kanaleve të hapura dhe të perdoret për qëllime rehabilitimi në fazë të ndryshme të shfrytëzimit ose për rehabilitimin e këtyre sipërfaqeve të dëmtuara në përfundim të afatit të veprimtarisë minerare.

- Gjatë proceseve të punës nuk do të dëmtohen sipërfaqe të panevojshme si pasoje e mos planifikimit të saktë apo e neglizhencës së punëtorëve që mund të presin peme apo të shkaktojnë zjarre dhe dëmtojnë peizazhin dhe bimësinë e zonës.

Në zonën në të cilën do të zhvillohet aktiviteti nuk ka ndonjë lloj ose specie flore apo faune që mbrohet me status të veçantë. Flora dhe fauna lokale nuk do të preket, mbasi sipërfaqja e objekti është po-thuajse e zhveshur nga bimësia. Megjithatë shoferet do të udhëzohen të bëjnë kujdes gjatë transportit në zona pyjore për të mos shtypur kafshë që mund të jenë në mes të rrugës.

Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar.

Ne zbatim të programit të punës për këtë leje minerare shfrytëzimi do të shtrihet sipas afatit që përcakton Ligji Minerare dhe aktet n/ligjore të miratuara në zbatim të tij përcaktojnë që afati i lejes minerare të shfrytëzimit është 25 vjet me të drejtë shtyrjeje 10 vjet. Prandaj edhe investimet që parashikohen të bëhen nga shoqëria “A-XH-2019” sh.p.k do të shtrihen brenda këtij afatit të ndarë sipas fazave dhe rradhës së kryerjes së operacioneve të punës për realizimin e programit minimal dhe pajisjeve e makinerive që duhen.

Në fazën e parë të shfrytëzimit (viti i parë +vitin e dytë) të zonës minerare të shfrytëzimit do të bëhet hapja e transhesë kryesore dhe ringritja e punimeve minerare nëntoksore ekzistuese, si dhe marrja e masave për realizimin e tyre. Gjithashtu që në fillim do të bëjmë të mirmbajtje të rrugeve për vajtje e mjeteve në objekt.

Gjatë vitit të dytë nga subjekti do të intensifikojmë punimet për kryerjen e punimeve dhe në varesi të rezultate do të përgatitemi për marrjen e masave për kryerjen e shpimeve (hapja e shesheve të punës në karrierë, dhe punimeve minerare) etj

Në fazën e dytë (vitin e tretë) do të vazhdojë hapja e karrierës dhe punimeve minerare nëntoksore dhe do të vazhdojë nxjerrja e mineralit të kromit.

Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje të madhe fizike, dhe objekti ndodhet në distance të konsiderueshme nga zona me e afert e banuar. Zhurmat që krijohen gjatë fazës së shfrytëzimit nuk përbejnë ndotje akustike. Analiza e frekuencës të zhurmës të emetuar nga këto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen në mesataren e frekuencës 100 – 150 Hz , e cila është e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha në të cilën do të jenë të pranishme këto zhurma është vetëm gjatë ditës, meqenëse në objekt do punohet vetëm me një turn. Niveli i zhurmave të këtyre mjeteve në largësi nuk do të jetë i madh dhe do të jetë konform normave në fuqi.

Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin.

Pjesa e relievit ku do të zbatohet aktiviteti i shfrytëzimit të mineralit të kromit, është pjesërisht i cënuar nga punime nëntokësore, gërmime dhe shpime të kryera vite me parë nga ish/ ndërmarrja gjeologjike Tropojës, si dhe nga punimet e kërkimit shfrytëzimit të kryera gjatë kohës për marrjen e lejes minerare të kërkimit shfrytëzimit.

Gjithashtu shënojmë se kjo zona është e varfër për nga zhvillimi i bimësisë.

Në përfundim të aktivitetit minerar të shoqërisë tonë me marrjen e lejes, e cila është caktuar në bazë të ligjit 25 vjet, njëkohësisht do të transformohen sipërfaqet e dëmtuara nga punimet tona, në një reliev të

ri natyror, në një sipërfaqe në formën e sotme por të mbuluar nga vegetacioni dhe në terrene të gjelbëruara. Masat për rehabilitimin e sektorëve të sipërpërmendur që cenojnë terrenet do të zbatohen progresivisht me shfrytëzimin, hap pas hapi, krahas aktivitetit të shfrytëzimit dhe konsistojnë në:

1. Sistemimin në sipërfaqen ekzistuese ku do të zhvillohet shfrytëzimi nëpërmjet mbjelljes së pemëve për të rritur kohezionin e saj pasi të këtë përfunduar puna;
2. Hapja e gropave ku do të mbillen fidanët dhe mbushjen e tyre me dhera vegjetale;
3. Mbjelljen e sipërfaqeve të krijuara si më sipër dhe sipërfaqeve të reja në territorin e zonës me pemë natyrore (pisha, etj.) dhe barishte të ndryshme;
4. Mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella për një kohë 1 vjeçare pas dorëzimit të lejes së shfrytëzimit;

Duke konsideruar sipërfaqet e shesheve që zënë punimet e projektuara për shfrytëzim prej 500 m², në tabelën e mëposhtme jepen shpenzimet e rehabilitimit:

Duke konsideruar sipërfaqet e shesheve që zënë punimet e projektuara për shfrytëzim prej 500 m², në tabelën e mëposhtme jepen shpenzimet e rehabilitimit:

Në përgatitjen e programit të monitorimit është menduar që të përzgjidhen për t'u monitoruar nga vete kompania ata elemente që realisht mund të identifikohen, maten, regjistrohen dhe komunikohen në organet e administrimit të mjedisit (ARM). Të dhënat cilësore, sipas tabelës do të hidhen në një regjistër që administrohet nga vete kompania dhe do të dorëzohen në ARM-ne e qarkut sa here të kërkohet, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve.

Më poshtë jepen disa indikatorë të cilët duhen monitoruar për të vlerësuar suksesin dhe matur realizimin e objektivave mjedisore të projektit. Interpretimi i një gjendje të caktuar mjedisore duhet beërë në lidhje të ngushtë me fazën në të cilën gjendet zbatimi i projektit. Duhet kuptuar se një gjendje e përkeqësuar e mjedisit në një fazë të caktuar të zbatimit e cila është fazë transitore dhe jo tregues absolut i realizimit të objektivave të projektit

Elementet e monitorimit të veprimtarisë

Nr	<i>Elementi i monitorimit</i>	<i>Frekuenca</i>
1.	Monitorim i zhurmave dhe pasojave të plasjeve	Vazhdueshëm
2.	Monitorimi i biodiversitetit në zonën rreth objektit	Vazhdueshëm
3.	Monitorimi i pluhurave në objekt dhe gjatë transportit	Gjate stinës së thatë
4.	Monitorimi i gjendjes së mekanikes, për rrjedhje dhe ndotje	Vazhdueshëm
5.	Monitorim i faktorëve që shkaktojnë rreziqe natyrore dhe humane	Vazhdueshëm

Efikasiteti i masave të Planit të Menaxhimit do të vlerësohet nga rezultatet e tij konkrete në terren nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm. Plani i Menaxhimit do të përmirësohet dhe përshtatet në të ardhmen në varësi të kërkesave praktike.

Subjekti do të kujdeset për administrimin e çdo informacioni që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë. Administrimi i të dhënave konsiderohet shumë i rëndësishëm për mënyrën e operimit të subjektit dhe do të përdoret për të përmirësuar efikasitetin e çdo mase të parashikuar për zbatimin e ndikimeve në mjedis dhe në tërësi. Për mbajtjen e të dhënave do të përpilohet një regjistër i veçantë, fushat e të cilit të mbulojnë të gjithë llojin e informacionit të mbledhur që lidhet me aktivitetin e minierës.

Llogaritja e garancisë financiare për realizim të planit të rehabilitimit për lejen e shfrytëzimit (zona minerare 659/1) në bazë të udhëzimit të ministrit të METE-s nr.718 d.t 3/07/2011.

Llogaritja e vlerës së garancisë financiare vjetore për rehabilitimin përfundimtar të mjedisit

Sipërfaqet që do të rehabilitohen :

Nr	Emertimi	Sasia	Ne m ²	Ne Ha
1	Karriera Nr.1	5	31 526	3.15
1.a	Sipërfaqja që preket nga punimet minerare	1	19087	1.9
1.b	Sipërfaqe e shesh depozitimeve	3	8025	0.8
1.c	Sipërfaqja e rruges hyrese	1	4414	0.44
2	Karriera Nr.2	4	12 029	1.2
2.a	Sipërfaqja që preket nga punimet minerare	1	5475	0.55
2.b	Sipërfaqe e shesh depozitimeve	2	4621	0.46
2.c	Sipërfaqja e rruges hyrese	1	1933	0.2
3	Totali	8	43 555	4.35

Sipërfaqet totale që duhet të rehabilitohen janë eshte 43 555 m² ose 4.35 Ha

Preventivi I rehabilitim per 1 ha per zonen e shfrytezuar								
Nr.	Operacioni	Sipërfaqja	Normati va ha/ha	Sip. Operac. ha	Normati va m ³ /ha oper.	Volumi I punes m ³	Çmimi lek/ha	Vlera
I	Plani I mbylljes se karrieres							
a	Krehje sistemim I faqeve anesore	1	0.7	0.7	200	140	50	7000

	Shuma I								7000
II	Plani I menaxhimit te mbetjeve								
a	Sistemim I mbetjeve te zbulimit	1	1	1	1800	1800	15	2700 0	
b	Sistemim I mbetjeve teknologjike	1	0.1	0.1	2000	1800	15	2700 0	
	Shuma II								54000
II I	Plani I rehabilitimit perfundimtar te mjedisit								
a	Mbushje me dhe produktiv I sheshit fundor	1	1.1	1.1	3000	3300	35	1155 00	
b	Hapje gropash	1	1	1	300	300	100	3000 0	
c	Blerje pemesh	1	1	1	300	300	1000	3000 00	
d	Mbjellje pemesh	1	1	1	300	300	50	1500 0	
e	Sherbime	1	1	1	300	300	50	1500 0	
			norm, ml/ha		gjatesia ml	volumi m3	çmi mi		
f	Kanali i ujrave te larta, drenazhim	1	300		300	75	200	1500 0	
	Sinjalistike							5000	
	Shuma III								495500
	SHUMA (I+II+III)								556500
	Shpenzime suplementare 5%								27825
	TOTALI								584325

Siperfaqia e shfrytëzuar nga punimet sipërfaqësore është 4.35 Ha per nje periudhe 25-vjecare.

4.35 Ha x 584 325 leke /Ha= 2 541 814 leke.

Ne zbatim te Urdherit te Ministrit te Ekonomise, Tregetise dhe Energjetikes nr.718 date 03.10.2011 “Per Menyren e vleresimit te Garancive Financiare te Lejeve Minerare” vleresojme garancine financiare te realizimit te rehabilitimit per lejet minerare te shfrytezimit per Grupin e Mineraleve Metalore per nje miniere nentokesore te hapur me punime horizontale. Ne zbatim te Aneksit 4 japim preventivin e planit te rehabilitimit per 1 Gryke galerie.

I							
Plani i mbylljes se minieres							
Nr	Emertimi	Seksioni (m2)	Trashesia e murit	Volumi I murit	Norma Ore/m3	Koha e punes (ore)	Vlera (lek)
a	Mur Betoni	5.2	0.6	3.12	3.5	12.01	131.1
b	Operacione ndihmese	5.2				5.41	28.132
Shuma (a +b)		159.28					
c	Shpenzime per fuqi punetore	Ore pune	Nr. punetoreve	Ore pune gjithsej	Lek/ore pune		Gjithsej
		17.42	4	69.68	280		19510.4
d	Shpenzime per materiale	Seksioni (m2)	Volumi I murit	Norma kg/m3	Sasia (kv)	çmimi (lek/kv)	Vlera (lek)
d1	Çimento	5.2	3.432	300	10296	1300	13385
d2	Inerte ndertimi	5.2	Volumi I murit	Koeficienti (m3/m3)	Sasia (m3)	çmimi (lek/m3)	Vlera (lek)
			3.432	1.3	4.4616	1200	5354
d3	Elektroda	5.2	Sasia (Kg)	çmimi per njesi			Vlera (lek)
			25	160			4000
d4	Energji elektrike	5.2	120	14.4			1728
d5	Derrasa	5.2	0.5	15000			7500
d6	Materiale te tjera	5.2					1200
g	Transport		Volumi (ton)	Distanca (km)	Çmimi (lek/ton km)		Vlera (lek)
			10.7	30	10		3210
h	Transport I brendshem						20000
Shuma (d - h)		75887.4					
SHUMA I		76046.7					
II							
Plani I menaxhimit te mbetjeve							
a	Çmontim paisje makineri, ndertesa ne siperfaqe	Volumi (ton)	Ore pune	Paga (lek/ore)			Vlera (lek)
		20	100	25			25000

b	Transport makineri, mbeturina	Volumi (ton)	Distanca (km)	Çmimi (leke/ton km)		Vlera (lek)
		20	30	12		7200
c	Mbushje me dhe' e portalit	Volumi (m3)	Çmimi (lek/m3)			Vlera (lek)
		100	30			3000
SHUMA II						35200
III	Plani perfundimtar i rehabilitimit te mjedisit					
a	Tarracimi dhe sistemimi I stokut te sterilit	Sip (m2)	norma (m2/dit)	dite pune	leke/dite pune	Vlera (lek)
		100	40	2.5	2400	6000
b	Mbushja me dhe' e stokut te sterilit	Sip (m2)	Volumi (m3)	Çmimi (leke/m3)		Vlera (lek)
		100	400	30		12000
c	Sistemimi i sheshit industrial, mbushje me dhe'	Sip (m2)	Çmimi (leke/m2)			Vlera (lek)
		100	30			1600
d	Blerje pemesh	Sip (m2)	Nr / m2	Nr. Pemeve	Çmimi (leke)	Vlera (lek)
		100	0.04	8	1000	8000
e	Mbjellje pemesh	100	0.04	8	200	1600
f	Rrethim					30000
g	Kanalizime, drenazhime					15000
h	Sinjalistike lajmeruese parandaluese					10000
SHUMA III						87200
SHUMA I + II + III						196670
Shpenzime suplementare 5%						9834
TOTALI						206504

Sipas projektit mendohen te hapet vetem 1 traverbang per kerkim-zbulimin e mineralit te kromit ne thellesi. Nga isha ndermarja gjeologjike jane te hapura 3 galeri kerkimi zbulimi. Bazuar ne ligjin minerar shoqeria merre persper rehabilitimin e tyre.

4 punime minerare x 206 504 leke /gryka= 826 504 leke.

Sa me siper do te kemi vlerat toale :

Vlera totale e rehabilitimit per siperfaqet e prekura :

2 541 814 leke

Vlera totale per mbylljen e grykave te punimeve horizontale : **826 504 leke**

Totali plani i rehabilitimit dhe mbylljes është : 3,368,318 Leke

Vlera vjetore e garancise financiare per realizimin e planit e mbylljes do te jete:

3,368,318 lek/ 25 vite = 134 732 leke ne vit.

Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis

Me qene se kemi te bejme me Leje Minerare te Shfrytezimit te mineralit te kromit ne siperfaqe e shpatin te nje kodre dhe ne thellesi ndikim negativ ne mjedis jane :

- Dëmtimi i sipërfaqes se tokës gjatë hapjes dhe kryerjes së punimeve te shfrytezimit.
- Depozitim te materialit te germuar ne siperfaqen e toke nga karriera dhe galerive
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve

Sa me siper Shoqeria “A-XH-2019” shpk do te marri masa qe sterilet qe gjenerohen nga zhvillimi i ketij aktiviteti do te depozitohen ne sheshet e percaktuara ne projekt. Ato gjate zhvillimi te aktiviteti do te perdoren si marteriale mbushesh per mbjelljen pemesh etj.

Nderson mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve apo ambalazhet do te grumbullohen neper thase te posatçem dhe do te transportohen drejt qendrave me te aferta te banuara per menaxhim nga sektoret perkates te pushtetit lokal.

Si pas planit te rehabilitimit do te merren masat për rigjenerimin e peisazhit;

Masat për rigjenerimin hap pas hapi, krahas shfrytëzimit të objektit konsistojnë në:

- 1.Krijimin e sipërfaqeve për mbjellje.
- 2.Sistemimin e materialit të mbulesës të depozituar
- 3.Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me fidanë pise dhe barishte të ndryshme;
- 4.Mirëmbajtjen e sipërfaqeve te mbjella;
- 5.Për shmangien dhe parandalimin e erozionit, shembjes së sipërfaqes dhe vithisjeve të ndryshme, në projekt është përcaktuar një sistem pune harmonik dhe i kombinuar në kohe dhe hapësire i zonës
- 6.Në zonën e shfrytezimit hap pas hapi dhe në përfundim të aktivitetit është parashikuar mbushja sistemimi, përpunimi dhe mbulimi i sipërfaqes që do të dëmtohet.
- 7.Kjo sipërfaqe e përfituar nga trajtimet e mësipërme do të japë mundësi minimale për rikultivimin e bimëve dhe pemëve te ndryshme lokale, duke krijuar kushte për parandalimin e erozionit dhe përmirësimit të pamjes së përgjithshme tëzonës së shfrytëzuar.
- 8.Gjatë veprimtarisë dhe në përfundim të saj do të ruhen parametrat e sipërfaqeve të mbuluara për të lejuar rrjedhën normale të ujërave të rreshjeve dhe parandaluar grumbullimin dhe shpëlarjen e sipërfaqes së shfrytëzuar dhe të mbuluar;

Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Projekti nuk ka ndikime ne mjedisin Nderkufitar.